



Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 23.01.2019

Numri i seancës për këtë çështje:
1 (një)

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Kolegji i Posacëm i Apelimit. Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Artan Laze.</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z. Artan Laze</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u shty në datën 28.01.2019, ora 11:00. Arsyeja: Për ti dhënë kohë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur konkluzionet përfundimtare.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Në këtë seancë dëgjimore nuk pati shpallje vendimi, por seanca u shty për shkak të pretendimit të subjektit dhe mbrojtësit të tij ligjor për një përgatitje (mbrojtje) sa më të saktë dhe më të plotë.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Trupa gjyqese (emrat)	<i>Kryesues: Sokol Çomo, Relatore: Albana Shtylla, Anëtarë: Ardian Hajdari, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit(OMN): zj.Elka Ermenkova.</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Sokol Hazizaj (Avokat)</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Amilda Celami</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u lejuan media, qytetarë të rastësishëm, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, si dhe kushdo që mund të ishte i interesuar. Numri total i të pranishmëve varionte 25-30 persona.</i>
Media e pranishme:	<i>Gazetarë dhe operatorë të mediave të ndryshme ishin të pranishëm.</i>

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	<i>Po/Jo</i>	<i>Nëse po, si u justifikua ai?</i>	<i>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</i>
D. Përmbajtja e çështjes	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
	<i>Ankimi i bazuar në: -Shkelje e procedurave ligjore, -Kërkesa për përjashtimin e një anëtari të trupës gjyqese të KPK-së, dhe nëse ka ndikuar ose jo në bazueshmërinë e vendimit të dhënë nga kjo trupë.</i>	<i>Kryesuesi i trupit gjyqes</i>	
		<i>Relatori i çështjes</i>	

	<p>KPK ka ndjekur procedurë ligjore jo korrekte që ka çuar në dhënien e vendimit në kundërshtim të plotë me nenin 74 dhe 75 të Kodit të Procedurës Civile, ndonëse gjykimi është administrativ. Bazuar në nenin 74, 75 të KPrC dhe në historikun e zhvillimit të procedurës, vendimmarrja nga e njëjta trupë gjykuese ka çuar në vendim të njëanshëm, jo të drejtë. Qëndrimi i zj. Brunilda Bekteshi, mënyra e drejtimit të seancës, ndërhyrjet e njëpasnjëshme deri në shpeshësi, deklaratimet verbale të komisioneres e cila jepte përgjigje pa bërë pyetjen, duke bërë kështu ndërhyrje arbitrare, të gjitha këto kanë shqetësuar subjektin e rivlerësimit. Vendimi i dhënë nga e njëjta trupë gjykuese ka cënuar procesin e rregullt gjyqësor dhe standardin e gjykimit. Sipas tij, zj. Bekteshi ka bazuar sjelljen, vendimmarrjen mbi bazën e paragjytimeve. Bazuar në nenin 4 të ligjit 84/2016 , nuk janë prezantuar 3 komponentët e gjykimit. Avokati thekson se kjo ishte një e drejtë e tyre. Z. Hazizaj përmendi edhe rastin e gjykimit të çështjes gjyqësore ku zj. Bekteshi ka qenë juriste pranë OSHE, dhe gjatë gjykimit të çështjes ka kërkuar përjashtimin e z.Laze si gjyqtar.</p>	Mbrojtja	
<p>z. Artan Laze fillimisht u shpreh rreth faktit se mbrojtësi ligjor i zgjedhur prej tij, në seancat vijuese mund ta përfaqësojë edhe në mungesë të tij. Z.Laze pohoi se me zj. Bekteshi nuk kanë pasur konflikt interesi prandaj edhe nuk janë ngritur kërkesa të tilla. Ankesa lidhet me tepër me drejtimin e seancës, si të njëanshme dhe paragjyuese. Subjekti ngriti pretendime edhe mbi fshirjen e një pjese të regjistrimit në disk, sipas tij është hequr pjesa kur ai ka kërkuar të marrë fjalën dhe nuk i është dhënë. Pohoi se kryetarja e trupit gjykues është prononcuar paraprakisht lidhur me këtë çështje para se të merrej vendimi. Gjatë gjithë kohës kur është zhvilluar seanca dëgjimore ka folur vetëm në emrin e saj, pa u konsultuar me anëtarët e tjerë të trupës. Bazuar në Rregulloren e KPK-së , pika 7, është shkelur parimi se të gjitha rastet për përjashtimin e anëtarëve duhet të shqyrtohen nga një tjetër trupë gjykuese. Veprimet e zj. Bekteshi shkojnë deri në veprën penale "Shpërdorim detyre". Vendimi duhet të shpallet i pavlefshëm pasi është në kundërshtim me ligjin</p>	Subjekti		
<p>z. Como i drejtoi pyetje subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtësit të tij ligjor lidhur me faktin nëse ka kërkesë konkrete mbi bazën e arsytimit ligjor për mënyrën sesi procedura administrative duhet të korrigjohet nga kjo trupë gjykuese.</p>	Kryesuesi i trupit Gjykues		
<p>Ndodhemi në rastin e pavlefshmërisë absolute, vendimi i dhënë në kundërshtim me ligjin procedural. KPA duhet të konstatojë duke mos u ndikuar nga vendimi i dhënë nga KPK, por duhet ta ndryshojë atë, duke e rrëzuar për shkaqe procedurale dhe thelbësisht ligjore.</p>	Mbrojtja		

	Z.Cómo konstatoi se KPA zotëron të gjitha materialet e fashikullit që KPK ka dorëzuar pranë KPA-së. Trupi gjykues e konsideroi shqyrtimin e këtij ankimi të përfunduar	Kryesuesi i trupit gjykues	
	Subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e seancës për një përgatitje sa më të saktë dhe më të plotë.	Subjekti	
		Komisionerët Publik	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Artan Laze, gjyqtar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë u paraqit e rregullt, në respektim të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Seanca dëgjimore filloi disa minuta me vonesë nga orari i përcaktuar, trupi gjykues u tërhoq për të administruar pretendimet e subjektit të rivlerësimit duke përcaktuar harkun kohor prej 30 minutash, por sërish pati një vonesë prej 15 minutash të tjera. Qëndrimi i zj. Brunilda Bekteshi, mënyra e drejtimit të seancës, ndërhyrjet e njëpasnjëshme, deklaratimet verbale të komisioneres u cilësuan si ndërhyrje arbitrare, duke shërbyer edhe si objekt i ankimit nga ana e z.Laze. Vendimi i dhënë nga e njëjta trupë gjykuese e KPK ka cënuar procesin e rregullt gjyqësor dhe standardin e gjykimit. Subjekti i rivlerësimit i cilësoi veprimet e zj. Bekteshi të barasvlershme me veprën penale “Shpërdorim detyre”. Përmasat e sallës nuk përmbushnin kushtet për të akomoduar të gjithë pjesëmarrësit në këtë seancë, ku numri i tyre varioonte rreth 25-30 persona. Trupi gjykues u tërhoq duke caktuar datën 28.01.2019 ora 11:00 për parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare.</p>		